



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 03

Prishtinë, më 29.12.2014, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Melihate Termkolli dhe Milena Miliqeviq.

Mungoi: Jakup Krasniqi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj – OSBE, Lekë Batalli – GLPS dhe Fitore Hajdini - ZPRK.

Nga Staf i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;

Kryetarja Albulena Haxhiu theksoi se në mbledhjen e kaluar i adresuam një kërkesë Kryesisë së Kuvendit me të cilën kërkuam që të ngarkohet Komisioni për Legjislacion, që ta shqyrtojë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, para shqyrtimit të dytë në mbledhjen plenare.

Deri tani nuk kemi përgjigje nga Kryesia e Kuvendit dhe ajo nuk e ka ngarkuar komisionin për shqyrtimin e raportit me amendamente. Si deputetë, ne kemi pranuar raportin me amendamente të Komisionit për buxhet, por nuk jemi të ngarkuar që t'i shqyrtojmë siç përcaktohet me rregulloren e punës. Haxhiu propozoi dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit që të përkrahet propozimi i saj, që në emër të komisionit në mbledhjen plenare të propozojë mocion procedural në pajtim me nenin 50.4 të rregullores, për t'ia kaluar Komisionit këtë çështje në shqyrtim.

Selvije Halimi ishte e mendimit që mund të shqyrtohen amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, pasi që siç tha ajo, ne si deputetë e kemi tashmë raportin para vetes, sepse të njëjtën gjë ka bërë edhe Komisioni për Integritet. Prandaj, mbi këtë bazë ta lëshojmë një shkresë përcjellëse, ku do ti drejtohem seancës me vlerësimin se amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa kanë bazë kushtetuese.

Kryetarja duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësës, tha se ne nuk mund ti shqyrtojmë amendamentet sepse nuk jemi të ngarkuar si Komision, por këtë raport që e kemi para vetes e kemi si material për mbledhjen plenare. Ajo edhe një herë lexoi vendimin e Kuvendit nr. 05-V-006, i cili nuk i ka ngarkuar Komisionet kryesore që ta shqyrtojnë Projektligjin.

Selvije Halimi tha se vendimi i Kuvendit e ka ngarkuar vetëm Komisionin për Buxhet si Komision Funkcional dhe nuk ka nevojë që të na ngarkojë neve sepse ne kemi obligim ta shqyrtojmë. Propozoj që për këto sqarime të ftohet në këtë mbledhje sekretari Kuvendit, pasi që ka qenë në mbledhje të Kryesisë dhe mund të na jep sqarime për këtë vendime.

Melihate Termkolli theksoi se këtu ka një problem parimor që e kam përmendur edhe në mbledhjen e kaluar sepse kjo nuk është çështje politike, por shumë profesionale. Ajo tha se raportin që e kemi para vetes e kemi marrë si material që do të shqyrtohet në mbledhjen plenare dhe nuk jemi ngarkuar që ta shqyrtojmë ne si Komision kryesor. Nëse kjo çështje kalon kështu do të kalojnë edhe shumë çështje tjera, e në këtë mënyrë dhe kjo nuk guxon të ndodhë. Ajo përkrahu kryetaren e komisionit që ajo të paraqet mocion procedural në seancë në emër të Komisionit, në pajtim me rregulloren e punës.

Armend Zemaj tha se lidhur me procedurat kemi diskutuar gjatë në mbledhjen e kaluar dhe nuk kemi çka të shtojmë tjetër. Por ajo që më shqetëson dhe më shumë është që edhe në këtë raport që e kemi sot, nuk janë përfshi amendamentet e propozuara nga deputetët. Ne si deputetë kemi dorëzuar dy amendamente më 24.12.2014, rreth orës 15:00, kurse raporti i Komisionit për Buxhet dhe Financa është protokolluar më 26.12.2014, që i bie së me kohë i kanë pasur amendamentet, por pse nuk i kanë përfshi nuk e di arsyen.

Zemaj ishte i pajtimit që kryetarja të kërkojë që të respektohet rregullorja ngase siç tha ky, nuk sheh as edhe një arsye, pse mos të ngarkohen Komisionet kryesore.

Nezir Çoçaj tha se seanca plenare jep përgjegjësitë për Komisionet edhe si Komision jemi themeluar nga Kuvendi dhe në bazë të rregullores, jemi të obliguar të shqyrtojmë këtë raport të Komisionit për Buxhet dhe Financa sepse kjo është detyrë dhe përgjegjësi e këtij komisioni.

Kryetarja Albulena Haxhiu rikujtoi edhe njëherë duke thënë se ne nuk mund ta shqyrtojmë këtë raport, sepse nuk jemi të ngarkuar si Komision. Këtë raport që e kemi para vetes e kemi material për mbledhjen plenare që do të mbahet sot.

Agim Aliu tha se kemi diskutuar gjatë për këtë çështje dhe pasi që është puna e pare e këtij komisioni në këtë mandat, si dhe për shkak të procedurave të përshpejtuara, të bëjmë një vërejtje që në rastet tjera të mos përsëriten procedura të tilla, sepse mund të krijohet si precedent, pasi shihet se ka një anashkalim të rregullores. Kjo vërejtje do të ishte konsensuale edhe brenda komisionit, në mënyrë që në të ardhmen mos të kalojë asnjë projektligj pa kaluar në Komisionin për Legjislacion, tha Aliu.

Kryetarja duke u ndërlidhur me parafolësin, tha se në momentin kur kjo çështje kalon kështu, kjo bëhet precedent, dhe nuk besoj që ka ndonjë problem që seanca shtyhet për 30 minuta, që ta shqyrtojmë si Komision.

Pas diskutimeve, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni vendosi që Kryetarja e Komisionit në mbledhjen plenare të datës 29.12.2014, në emër të Komisionit të paraqesë mocion procedural në pajtim me nenin 50.4 të rregullores për t'ia kaluar Komisionit këtë çështje në shqyrtim, para shqyrtimit të dytë të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2015.

3. Të ndryshme.

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 9:35.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja Komisionit
Albulena Haxhiu
